

## **Raport Monitorimi Janar –Prill 2024**

Në kuadër të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr.97 dt.07.12.2023 ”Për buxhetin e vitit 2024”, të udhëzimit nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është hartuar raport monitorimi për periudhës Janar – Prill 2024, për institucionin e Avokatit të Popullit

Ky raport mbështetet në vizionin por dhe detyrimet kushtetuese të Avokatit të Popullit, si institucion kombëtar në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në fokus të së cilit është ndërtimi i një shoqërie të bazuar në të drejtën në të cilën institucionet shtetërore janë llogaridhënëse ndaj qytetarëve dhe veprojnë në mënyrë transparente, të drejtë, efektive dhe efincente. Kjo përjasje është reflektuar në punën e institucionit për të garantuar, që institucionet publike të veprojnë në përputhje me standardet dhe aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Me një pozitë të tillë institucionale, pritshmëritë legjitime të publikut dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë të shoqërisë sonë kanë qenë dhe janë ende të larta në krahasim me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit. Në funksion të kapaciteteve dhe burimeve institucionale dhe duke marrë parasysh realitetet politike, ligjore, sociale, ekonomike, zhvillimore dhe kulturore të Shqipërisë, ambicia strategjike e Avokatit të Popullit është të bëhet aktori kryesor në funksionimin e sistemit kombëtar të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

### **➤ Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024**

Në mbështetje të ligjit nr.97 dt.07.12.2023 ”Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”- i ndryshuar, , performanca e produkteve të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për periudhën Janar - Prill 2024 paraqitet si më poshtë:

- **Programi - “Shërbimi Avokatisë”**

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) kanë bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të alokuara me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.23917 prot, datë 28.12.2023 “Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024-2026”, si dhe qëllimin e arritjeve dhe objektivave të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2024-2026).

➤ **Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2024**

Fondet e akorduara si dhe rialokimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, , paraqiten në tabelat e mëposhtme:

**Informacion per planifikimin dhe realizimin e fondeve buxhetor për vitin 2024**

**Tabela nr. 1**


Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar 2024	Plani i rishikuar viti 2024	Fakti Janar-Prill 2024
600	Paga	129,125,000	129,125,000	41,999,525
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	18,584,000	18,584,000	5,920,524
602	Mallra dhe shërbime të tjera	24,100,000	24,100,000	5,445,154
605	Transferta. Korente të Huaja	1,700,000	1,700,000	1,368,570
606	Transf për buxhetet familjare	700,000	700,000	53,590
600-231	Fondi të ardhurave nga marëveshje bashkëpunimi	2,638,379.35	5,740,525.19	1,763,179
231	Investimet	4,000,000	4,000,000	0
	<b>TOTALI</b>	<b>180,847,379.35</b>	<b>183,949,525.19</b>	<b>56,550,542</b>

**Informacion mbi realizimeve të shpenzimeve në %**


**Tabela nr. 2**

Nr.	Emërtimi	Plani i rishikuar viti 2024	Fakti Janar –Prill 2024	Diferenca deri në fund të vitit	Realizimi në %
1	Paga	129,125,000	41,999,525	87,125,475	32.53
2	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	18,584,000	5,920,524	12,663,476	31.86
3	Mallra dhe shërbime të tjera	24,100,000	5,445,154	18,654,846	22.59
4	Transferta Korente të Huaja	1,700,000	1,368,570	331,430	80.50
5	Transferta për buxhetet familjare	700,000	53,590	646,410	7.66
6	Fondi të ardhurave nga marëveshje bashkëpunimi	5,740,525.19	1,763,179	3,977,346	30.71
7	Investimet	4,000,000	0	4,000,000	0.00
	<b>Totali</b>	<b>183,949,525.19</b>	<b>56,550,542</b>	<b>127,398,983</b>	<b>30.74</b>


### Informacioni për planifikimin dhe realizimin e fondeve deri me 30.04.2024



### Plani i shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2024



### Struktura e fondeve të alokuara për vitin 2024



## 1-Shpenzime Personeli

- Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën e miratuar me shkresat e MF nr.23917/158 prot, datë 13.02.2024 “Miratimi i numrit të punonjësve për vitin 2024 dhe nr.20012/82 prot, datë 02.02.2024 “Dërgohet detajimi i numrit të punonjësve me kontratë,për vitin 2024”. Fondi i akorduar për vitin 2024, për mbulimin e shpenzimeve për paga personeli është 129.125.000 lekë, ndërsa realizimi për periudhën Janar - Prill 2024 është 41.999.525 lekë ose 32.53 % e fondit total për vitin 2024.
- Realizimi i fondit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore bazuar në planin e alokuar për vitin 2024 prej 18.584.000 lekë është realizuar 5.920.524 lekë ose 31.86% nga fondi total për vitin 2024.Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për periudhën Janar –Prill 2024 janë realizuar në masën 32.44 % ndaj planit buxhetor të alokuar, si rezultat i vakancave të krijuara gjatë kësaj periudhe..

**2.-** Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime (**zëri 602**) për periudhën Janar – Prill 2024 është 24.100.000, ndërsa realizimi Janar –Prill 2024 është 5,445,154 lekë ose 22.59 % e fondit buxhetor vjetor. Për këtë periudhë shpenzimet operative, janë përdorur kryesisht për shpenzime kancelarie, elektrike, postare, uji, telefonike, postare, karburant, shërbime profilaktike,dieta brenda dhe jashtë vendit., si dhe shpenzime për taksa të paguara bazuar në legjisllacionin në fuqi.

**3.-** Fondi për transferta korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2024 është 1,700,000 lekë, ndërsa realizimi për kuotat e anëtarësimit është 1.368.570 lekë ose 80.50 % i buxhetit vjetor të alokuar.

**4.-** Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar – Prill 2024,është 700,000 lekë, ndërsa realizimi është 53.590 lekë ose 7.66 % i buxhetit të alokuar .

**5.-**Fondi i të ardhuarve nga marrëveshjet e bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm është 5.740.525.19 lekë të ardhura nga të cilat janë përdorur 1,763,179 lekë ose 30.71 % e të ardhuarve të realizuara.

**6.-** Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 4,000,000 lekë. Aktualisht një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi është në proces prokurimi.

